



Buletini Alb-Shkenca

ORGAN I PËRMUAJSHEM I BOTUAR NGA FORUMI I STUDIUESVE DHE SHKENCETAREVE SHQIPTARE ALB-SHKENCA ■ DHJETOR 2005

www.alb-shkenca.org ● <http://alb-net.com/pipermail/alb-shkenca> ● e-mail buletini@alb-shkenca.org

© Duke respektuar të drejtën e autorit asnjë material i botuar këtu nuk mund të riprodhohet pjesërisht ose plotësisht pa lejen e Alb-Shkencës

RISTRUKTURIMI I RRJETIT TE KERKIMIT SHKENCOR NE SHQIPERI

Ditët e fundit në Alb-Shkenca janë diskutuar gjerësisht mundësitë dhe rrugët për ristrukturimin dhe reformimin e kërkimit shkencor në Shqipëri pas mesazhit që Myqerem Tafaj, këshilltar i kryeministrit Berisha dhe anëtar i vjetër i forumit tonë dërgoi në adresën tonë. Më poshtë mund të lexoni pjesën e parë të përmbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të ndryshëm të Alb-Shkencës në këtë drejtim.

Myqerem Tafaj: Për ristrukturimin e rrjetit të kërkimit shkencor po punon prej dy muajsh një grup profesorësh i ngritur për të konsultuar Këshillin e Ministrave. Grupi u dërgoi të gjithë instituteve dhe universiteteve një skedë vlerësimi me tregues standard për kapacitetet dhe outputet dhe tani po i studion për të nxjerre rekomandimet përkatëse.

Studimi mbështetet në parimin që të kontribuojë për integrimin e dy anëve të sistemit, kërkimit dhe mësimin, si dhe të shohë mundësitë e riorganizimit të të gjithë sistemit për të fuqizuar kërkimin në fushat me përparësi.

Mendimet e kolegëve janë shumë të mirëpritur.

Sapo të shpallet raporti i grupit të punës ai do të shpërndahet edhe në internet.

Evan Rroço: Më vjen shumë mirë që u shtrua për diskutim një problem që ka lidhje me organizimin dhe mirëfunksionimin e shkencës në Shqipëri.

Nga artikulli i botuar në gazetën *Panorama*, të lihej përshtypja se po përgatitet zhdukja e instituteve që sot janë nën varësinë e Akademisë së Shkencave. Nëse bëhet fjalë për një gjë të tillë, do të ishte një gabim i madh, ose të pakten një mini-reformë e destinuar të dështojë.

Mendoj se këtu bëhet fjalë për diçka më të madhe, pra për ristrukturimin e gjithë sistemit kërkimor në Shqipëri. Ky ristrukturim do të ketë si

pjesë të tij edhe institutet kërkimore në varesi të Akademisë së Shkencave.

Duhet të themi paraprakisht që në Shqipëri ekzistojnë disa dhjetra institute kërkimore, puna e të cilave jo rrallë ka një efikasitet që le shumë për të dëshiruar. Shqipëria ka disa universitete (me tepër se sa ka nevojë) ku duhet të kryhet punë kërkimore e ka edhe institutet. Pra shumë qendra shkencore dhe shumë pak shkencë.

Niveli i punës kërkimore në pjesën më të madhe të rasteve varet edhe nga niveli i investimeve që duhet të kryhen në paisje, literature etj. Në kushtet e një mungese të theksuar të fondeve paisja e laboratorëve (pa përmendur kushte elementare si energjia elektrike dhe uji) është përtokë. Këtu lind pyetja nëse do të jetë më efektiv krijimi i strukturave të unifikuara ku të mund të punojnë kërkuesit e instituteve dhe të fakulteteve respektive, apo do të vazhdohet të punohet paralelisht duke shpërndarë fonde kryesisht për të mbajtur në punë njerezit pa krijuar kushte për kërkim dhe duke i lënë kërkuesit (jo rrallë) të vegjetojnë?

Në artikullin e gazetës *Panorama* përmendeshin meritat e instituteve që janë nën ombrellën e Akademisë së Shkencave. Asnjëri nuk e vë këtë në diskutim. Por të diskutojme në parim, a nuk do të ishte më mirë që Instituti i Gjuhësisë (i cili është reduktuar në minimum) të shkrihej në një strukturë me departamentet përkatëse të Fakultetit të Gjuhësisë? Unë mendoj se po. Në këtë mënyrë do të kishim një shfrytëzim më efektiv të fondeve në dispozicion, do të mundësohej një bashkëpunim më efektiv i kërkuesve etj. Sigurisht në rast se cmira për të qenë i pari do të pengonte bashkëpunimin, reforma nuk do të ishte e suksesshme. Shembulli i Institutit të Gjuhësisë është ndoshta një nga ata që kanë më pak nevoja për fonde dhe ku bashkimi me departamentet e Fakultetit ishte më pak i ndjeshëm.

Një gjë e tillë nuk mund të thuhet p.sh. për Institutin e Fizikës Bërthamore dhe Departamentin e Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Laboratorët e tyre kushtojnë miliona dollarë dhe dublimi është krejtësisht i pajustificueshëm.

Ka patur disa propozime qysh në vitin 1992 fillimisht për sektorin e bujqësisë e më pas edhe për sektorë të tjerë. Ka patur edhe një vendim të qeverisë së atëherëshme për transferimin e disa instituteve kërkimore të bujqësisë pranë Universitetit Bujqësor, që nuk u realizua për interesa të vogla të personave që drejtonin këto institute. Ka patur përpjekje të tjera në mesin e vitit 1994 të cilat nuk përfunduan me sukses për arsye të kundërshtimit të Ministrisë së Bujqësisë që shihte largimin e instituteve si kufizim të fuqisë së saj etj.

Në vitin 1996 u krijua në këtë drejtim edhe Ministria e Arsimit të Lartë e të Shkencës, në modelin e simotrave të Europës perendimore. Ky do të ishte institucioni koordinues i të gjithë kërkimit. Diçka po lëvizte, ndonëse jo gjithçka me shpejtësinë e duhur. Fatkeqësisht pas çmendurisë kolektive të vitit 1997, siç e kemi zakon, "bashkë me ujin e qelbur hodhëm edhe foshnjën". Së bashku me shumë gjëra që duheshin ndryshuar, përbuzëm edhe gjëra që ishin nisur në udhë të mbarë. Kërkimi në Shqipëri vazhdoi të vegjetojë pa mbështetje edhe për tetë vjet të tjerë.

Nevoja për ristrukturim është mëse e domosdoshme. Të shpresojmë që do të bëhet në kahun e duhur dhe do të mbështetet me mjetet e duhura.

Auron Tare: Ristrukturimi dhe reforma në shumë institucione shkencore në Shqipëri është një nevojë urgjente. Nga përvoja ime personale 6-7 vjeçare me disa institucione si Instituti i Arkeologjisë p.sh., mendoj se ata janë kthyer në "kulotëza" personale të disa drejtuesve të cilët me çdo kusht i kontrollojnë ato për përfitime personale apo të miqve të tyre. Këto institucione për numrin e madh të personelit dhe të profesorëve që kanë nuk e justifikojnë absolutisht prodhimtarinë vjetore e cila duket mirë nga publikimet apo efektiviteti që kanë në terren. Shumë nga këta profesorë janë shtojca të disa prej projekteve të të huajve nga marrin "dietat" që këto misione ju paguajnë jo ligjerisht duke krijuar kështu një qoshe "intelektuale" të rehatshme pa u përfshirë në asnjë sfidë për të cilën Shqipëria ka shumë nevojë.

Nëse vërtet këto institucione do të reformoheshin me drejtues të rinj me vizion dhe kurajo dhe do të krijonin një pavarësi ekonomike në bazë të projekteve të tyre, do të sillnin një frymë të re në shkencën shqiptare dhe do të krijonin një klimë të shëndoshë bashkëpunimi e respekti me kole-

gët e tyre shqiptarë dhe të huaj që punojnë në Shqipëri. Fatkeqësisht disa nga shkencëtarët tanë të moshuar nuk janë më tepër se imazhe të mjera të së kaluarës së tyre servile ndaj diktaturës, e tashmë në shërbim të atyre që u pagujnë "dietat" mujore për punë shkencore fiktive.

Niko Qafoku: Eshtë pa dyshim për tu përshëndetur ideja juaj dhe e qeverisë për të reformuar rrjetin e instituteve shkencore dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në të kaluarën kemi diskutuar gjatë tek Alb-Shkenca rreth këtyre problemeve. Më vjen mirë që ju Myqerem, që keni qenë aq aktiv në këto diskutime dhe keni shkruar shumë artikuj në lidhje me strategjinë e kësaj reforme, po ju jepet rasti që ta bëni atë realitet. Gjithashtu mendoj se krijimi i grupit konsulent të profesorëve pranë kryeministrisë është një hap në drejtimin e duhur.

Unë jam shumë i interesuar të di detaje rreth problemeve që po diskutohen aktualisht në grupin konsulent. Ju thatë që parimi kryesor ku po mbështetet reforma është ai i integritetit të mësimin me shkencën. A ka mundësi të na tregoni se si është menduar të kryhet kjo në kushtet konkrete të Shqipërisë.

Një diskutim i hapur dhe me pjesëmarrjen e sa më shumë diskutuesve do të bënte që edhe rekomandimet që do t'i jepen qeverisë të jenë sa më të mbështetura, reale, apolitike dhe që vërtet i shërbejnë interesave të Shqipërisë. Interneti ka krijuar mundësinë e grupimit të qindra studiuesve shqiptarë të cilët kanë një përvojë të gjatë qoftë në Shqipëri ashtu edhe në vendet ku kryejnë veprimtari shkencore apo mësimore.

Falë punës së tyre dhe nivelit të jashtëzakonshëm profesional ata kanë arritur që të japin kontribute vërtet të shquara si në shkencë ashtu dhe në mësimdhënie. Ndoshta ka ardhur vërtet koha që kjo forcë e madhe intelektuale të japë një kontribut real për transformimin rrënjësor të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë në Shqipëri.

Myqerem Tafaj: Me pak fjalë, sistemi i sotëm tregon se ka një ndarje të qartë midis arsimit të lartë dhe kërkimit. Akademia ka mbetur insitucioni që është mbështetur për kërkim, ndërsa universitetet për mësim. Institutet e ministrive janë zhvilluar në një rrugë shumë spontane duke u mbështetur për kërkim dhe këshillim. Rezultati është shumë i thjeshtë: institucionet e arsimit të lartë thuajse nuk kryejnë kërkim, akademia bën

kërkim më shumë aplikativ dhe disa shërbime ndërkohë që në shkencat albanologjike realizon botimet më të mira në vendin tonë. Ndërsa *output* i insituteve të minsitrive është minimal si për prodhimin ashtu edhe për shkencën.

Në kushtet e vendit tonë me burime shumë të kufizuara një situatë e tillë nuk mund të tolerohet ende. Na duhet të gjejmë rrugët më të përshtatshme për:

1. Rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve njerëzore dhe materiale të vendit;
2. Investimin me përparësi për kërkimin dhe zhvillimin në fushat prioritare;
3. Vënien më mirë të kërkimit në shërbim të përgatitjes së studentëve sidomos ata të nivelit MSc dhe PhD.

Grupi po studion paralelisht të dy anët e sistemit, pra rrjetin e kërkimit dhe atë të universiteteve. Ne mendojmë se reforma duhet të shoqërohet me ndryshime të ndjeshme strukturore në të dy këto drejtime.

Universitetet, së paku tre të Tiranës (U. i Tiranës, U. Politeknik dhe U. Bujqësor), duhet të rifitojnë funksionet e domosdoshme kërkim, zhvillim, transferim të teknologjisë/njohurive për prodhimin dhe komunitetin ku janë. Mund të duket paradoksale, por sot shumë pak kolegë besojnë se edhe universitetet duhet të kryejnë kërkim, zhvillim, transferim të teknologjisë!

Deri tani grupi i punës mendon se një strategji afatgjatë zhvillimi do të ishte e suksesshme nëse dy anët e sistemit të integroheshin më mirë, për sa është e mundur. Kjo do të thotë që:

- disa institute kërkimore të bashkohen me departamentet homologe të univeristeteve;
- disa institute kërkimore më të mira dhe në fusha të rëndësishme mund të rigrupohen në formën e qendrave interdisiplinare kërkimi brenda universiteteve p.sh. për gjeoshkencat, për energjinë, ujin dhe mjedisin. Më vonë mund të mbështeten si qendra ekselence;
- disa institute të shkencave albanologjike për shkak të përparësisë që kanë mund të ishin një qendër albanologjike jashtë universitetit, por e riorganizuar për të qenë më efikase;
- mbi bazën e disa insituteve dhe departamenteve ekzistuese mund të ngrihet një fakultet për nutricionin human dhe bioteknologjinë, ku fusha të tilla prioritare të gjejnë një zhvillim prioritar;
- mbi bazën e disa bërthamave ekzistuese në akademi dhe universitete mund të ngrihet një fakultet i teknologjisë së informacionit, për të theksuar rëndësinë që ka zhvillimi prioritar i kësaj fushe në vendin tonë;

– institutet që kryejnë shërbime duhet të mbeten si të tilla por të riorientohen, sepse na rezulton se mbi 50% e instituteve kërkimore në vendin tonë synojnë të merren me mjedisin!

Ne mendojmë se një riorganizimin institucional do të rrisë përgjegjësinë e gjithë palëve për të ngritur nivelin cilësor të kërkimit dhe shkollimit universitar. Besoj se jemi të gjithë në një mendje, se një vend i varfër duhet të mendohet mirë se ku do të investojë me përparësi. Shqipëria nuk mund të bëjë shkencë për shkencë pa një output që i shërben mirë prioriteteve të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit.

Mendimet e kolegëve të Alb-Shkencës janë më shumë se të mirëpritur.

Do të fillojë hartimi i një masterplani për arsimin e lartë dhe shkencën (ALSH) për vitet 2006-2015. Kam biseduar me Këshillin e Evropës (KE) dhe Bankën Botërore (BB). KE ka pranuar idenë fillestare të masterplanit që ju tashmë e njihni (e kam shpërndarë në prill 2005). Në janar-shkurt do të ngrihet për herë të parë pranë Këshillit të Ministrave, Këshilli Kombëtar i Arsimit të lartë dhe shkencës (KALSH) i përbërë nga figura akademike dhe do të ketë rolin e një organizmi konsultativ. Misioni i tij do të jetë politikëbërja afatgjatë në ALSH. Ai do të ketë tre komisione: për investimet dhe financimin, për kurrikulën dhe kërkimin dhe ai i vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit. Në këto komisione do të përfshihen edhe ekspertë të tjerë që nuk janë anëtarë të KALSH-it, brenda dhe jashtë vendit. KALSH-i do të ketë të drejtë të ngrejë edhe grupe ekspertësh ad-hoc për probleme specifike. Do të përpiqemi të tërheqim edhe ekspertë të huaj. KALSH-i do të fillojë punën pikërisht me hartimin e masterplanit. Javën e dytë të shkurtit ky grup do të punojë me ekspertët e KE-së për diskutimin e objektivave të masterplanit.

Unë jam shumë i interesuar për të vendosur “ura të fuqishme lidhëse” me shkencëtarët tanë jashtë vendit, dhe kjo jo thjesht për efekte show apo të tjera formale, por për një shkak shumë të fortë: ajo që sot i mungon më shumë se çdo gjë tjetër vendit tonë është ekspertiza e nivelit të lartë, aq më tepër tani para nënshkrimit të marrëveshjes së asociimit në BE.

Dhe midis jush kaq aq shumë kolegë me karriere të admirueshme dhe nivel shumë të lartë ekspertize. Unë mund të them se kam mbështetjen maximale të kryeministrit për të gjetur rrugët më të mira, për ta institucionalizuar këtë *input* aq të domosdoshëm nga ekspertët më të mirë shqiptarë brenda dhe jashtë vendit. Ju e dini që ne kemi

filluar të konkretizojmë projektin "Brain Gain" në bashkëpunim me UNDP-në. Ne jemi duke diskutuar për format e kontributit të shkencëtarëve shqiptarë nga jashtë në universitetet tona, administratë dhe biznes. Në janar-shkurt do të jetë përfunduar edhe një web site për këtë.

Pas tre muajsh do të bëhen zgjedhjet në universitete dhe ne e kemi hapur të drejtën e konkurrencës për në organet drejtuese të departamenteve, fakulteteve dhe rektorateve për të gjithë ata që kanë gradën Doktor dhe jo siç ishte deri tani me gradën Profesor, sepse në këtë formë ishte ngushtuar shumë rrethi i atyre që kishim mundësi të konkurojnë. Do të përpunohen edhe disa kritere për kandidatët, ku do të stimulohen ata me përvojë të gjatë studimesh dhe punë në universitetet e huaja. Do të kenë të drejtë të konkurojnë edhe shqiptarët që janë jashtë vendit. Ju lutem, mos hezitoni të kandidoni nëse keni ndërmend të ktheheni në vendin tuaj!

Ditët e fundit qeveria vendosi të hapë Universitetin e Durrësit. Së shpejti krijohet bordi themelues i universitetit. Në këtë universitet do të jenë shkencat e administrimit, ekonomia e turizmit, mësuesia cikli i ulët, anglisht, kurse 1-2 vjeçare profesionale në fusha të ndryshme, kurse 1 vjeçare për trainimin e mësuesve. Ne dëshirojmë që të rekrutojmë në këtë universitet sa më shumë të rinj me MSc ose PhD të fituara në universitete të huaja me rezultate të larta. Nëse keni interes më tërëqori Cv-në tuaj të zgjeruar.

Sokrat Sinaj: Pa hyrë në komente do të thoja që nisma është jo vetëm për tu përgëzuar por e domosdoshme! Njëkohësisht duke u bashkuar me mendimin e Nikos që jo pak studiues shqiptarë ushtrojnë aktivitetin e tyre shkencor apo mësimdhënës në institucione apo universitete të njohur jashtë vendit dhe si të tillë kanë një përvojë jo të vogël do të ishte jo keq që të shihet mundësia e integritit edhe të ndonjerit prej tyre në grupin e punës (nëse nuk është menduar). Mundësitë e komunikimit elektronik tani lehtësojnë së tepërmi bashkëpunimin edhe pa qenë të pranishëm në të gjithë takimet në Tiranë. Në të njëjtën kohë do të sugjeroja që para se projekti që ju mendoni ti paraqisni qeverisë të merrte formën finale do të ishte jo keq të viley edhe mendimi i të interesuarve në Alb-Shkenca ku dihet që ka jo pak studiues të njohur. Ky mendim kritik/sugjerues do të ishte i çmuar dhe pa kosto!

Tanush Shaska: Z. Tafaj, përshëndes diskutimet

tuaja të hapura në këtë forum. Përderisa ju kërkua mendimet tona më lejoni që t'i them gjërat hapur dhe ashtu siç i shoh.

Në procesin e reformës së arsimit e shkencës mendoj se e vetmja pyetje themelore të cilës i duhet dhënë përgjigje është: Ç'ndryshime duhet të bëjmë që arsimit dhe shkencës të ketë ndikim sa më të madh pozitiv në ekonominë e Shqipërisë?

Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje natyrisht duhet të dimë se cilat janë degët dhe fushat me potencialin më të madh ekonomik në 10-30 vitet që do vijin. Unë jam skeptik se shumica e profesorëve të universiteteve të Shqipërisë e kanë këtë vizion. Për më tepër duke pasur parasysh "the greater appeal" që kanë shkencat jo-teknike tek publiku i gjerë dhe shumica e politikanëve, frika ime se shkencat teknike nuk do të zenë vendin kryesor në këtë reformë shtohet edhe më shumë. Në qoftë se ne do të vazhdojmë të përqendrohemi tek gjeoshkencat, uji, mjedisi, albanologjia, historia etj. do të jemi përsëri me vonesë (ashtu si në të shkuarën). Do të jetë më mirë të përqendrohemi tek shkencat teknike (si informatika, nanoteknologjitë, biomatematika, bioinformatika, komunikacioni dixhital, quantum computer etj.). Më kuptoni drejt, unë nuk po sugjeroj që ne të harxhojmë energjitë për të shpikur "quantum computer", por duhet të kemi njerëz e specialistë që kanë njohuri bashkëkohore në fushat teknike. Përqendrimi në degët e duhura si dhe legjitimizimi (nënkupto cilësia) e universiteteve tona duhet të jetë boshti kryesor i çdo reforme. Nuk është rastësi që gjithë investimet e perëndimit po shkojnë në Indi, Kinë e vende të tjera me nivel arsimor mjaft të lartë. Ne jemi në mes të Evropës dhe kemi potencialin njerëzor për t'a shfrytëzuar këtë shans. Unë shpresoj që kur të kryhet reformimi i institucioneve tona disa nga këto gjëra të kihet parasysh. E përsëris, nuk po kërkoj eliminimin e asnjë dege, por e kam fjalën për përqendrimin e arsimit dhe shkencës.

Ju thoni se është krijuar një grup pune për të konsultuar Këshillin e Ministrave. Cilët janë anëtarët e këtij grupi pune dhe përse përbërja nuk bëhet publike?

Disa nga ne kanë shpresa të mëdha tek zoti Tafaj dhe zoti Pollo. Unë shpresoj që ky të mos jetë rotacioni i radhës i të pa-aftëve.

(Pjesën e dytë të kësaj përmbledhjeje me mendime e sugjerime të tjera për reformën e institucioneve kërkimore-shkencore shqiptare do ta ndiqni në numrin e ardhshëm të Buletinit Alb-Shkenca)

GEZUAR VITIN E RI 2006!

*T*ë nderuar anëtare dhe ndjekës të Alb-Shkencës,

siç është fare e natyrshme, në adresën e Alb-Shkencës arritën me dhjetra mesazhe urimi për festat e fundit të vitit. Në pamundësi për t'i shpërndarë të gjithë këto shkrime dhe urime, po nisim në listën e forumit tonë këtë mesazh për t'i uruar të gjithë anëtarët dhe lexuesit e Alb-Shkencës kudo që punojnë dhe jetojnë:

Gëzuar Vitin e Ri 2006!

Qoftë ky një vit tjetër i mbarë për ju dhe familjet tuaja. Me ç't'ju dojë zemra!

Dhe mbi të gjitha me një Kosovë të lirë...

Për Alb-Shkencën viti që po mbyllim ishte pa as më të voglin dyshim një vit vërtet i suksesshëm. Aktualisht numri i anëtarëve të forumit tonë e ka kaluar shifrën 800, pra është gati dy herë më i madh se në fillim të këtij viti.

Forumit shërbeu si pikë virtuale takimi e të gjithë anëtarëve të vjetër e të rinj ku u diskutuan probleme me karakter të përgjithshëm e të veçantë si dhe u shprehën mendime për probleme që kanë lidhje me zhvillimin e shkencës dhe përmirësimin e punës në institucionet e arsimit tonë të lartë.

Gjatë vitit 2005 u përpilua letra që ju dërgua Kongresit Amerikan në përgjigje të pretendimeve të lobit grek në Amerikë për keqtrajtimin e minoritetit grek në Shqipërinë e Jugut.

Më pas u përgatit edhe thirrja e Alb-Shkencës për pavarësinë e plotë të Kosovës dhe u ofrua një grup konsultues për këtë problem.

Në vitin 2006 që sapo filloi ne do të vazhdojmë të çojmë më tej këtë traditë të nisur dy vjet më parë në mënyrë që zëri i diasporës shkencore shqiptare të dëgjohet gjithkund ku kërkohet profesionalizëm e ekspertizë për zgjidhjen e problemeve madhore me të cilat po ballafaqohen aktualisht shqiptarët.

Për këtë ju lutemi që të vazhdoni të mbështesni Alb-Shkencën duke dhënë kontributin tuaj të drejtpërdrejtë dhe ta reklamoni atë tek të njohurit, bashkëpunëtorët dhe studentët tuaj që mund të jenë të interesuar apo mund të përfitojnë nga anëtarësimi në këtë forum. Së bashku le ta çojmë më tej suksesin e Alb-Shkencës. Ne jemi veçanërisht të interesuar që ti shtojmë radhët tona me studiues, pedagogë dhe studentë universitarë e pasuniversitarë të të gjitha degëve shkencore.

Faqet elektronike të Alb-Shkencës në internet (www.alb-shkenca.org) tërheqin çdo ditë një numër të konsiderueshëm vizitorësh nga shumë vende të botës. Brenda harkut kohor të një viti ky web-site është vizituar më tepër se 28.000 herë, gjë e cila me të vërtetë na befaso.

Atje do të vazhdojmë të afishojmë punimet, shkrimet, komentet tuaja në mënyrë që ato të jenë sa më të dukshme dhe t'i shërbejnë një auditori gjithnjë e më të gjerë.

Në saje të punës vullnetare të disa anëtarëve dhe mbështetjes e inkurajimit të shumë anëtarëve të tjerë, Grupi administrues përgatiti gjatë këtij viti Statutin e Institutit Alb-Shkenca dhe planin e tij njëvjeçar të punës të cilët janë në procesin e votimit. Nëse dëshironi të bëni pjesë në grupin e anëtarëve themelues të këtij instituti, plotësoni formularin përkatës dhe dërgojeni në adresën e Grupit administrues ga@alb-shkenca.org

Së fundi ne po punojmë edhe për zgjerimin e seksioneve shkencore të Alb-Shkencës që do të shërbejnë si pika takimi të studiuesve të së njëjtës degë shkencore. Instituti do të fillojë botimin "Analet e Alb-Shkencës", ku do të përfshihen raporte shkencore, perspektiva dhe prezantime në konferenca e simpoziume, komente të ndryshme etj. Nëse dëshironi të botoni punimet në "Analet e Alb-Shkencës" mund ti dërgoni ato në adresën analet@alb-shkenca.org

**Ju urojme edhe një herë Gëzuar 2006!
Paqe, suksese e lumturi!**

GLOBALIZMI, ÇESHTJA E SHTETIT DHE KOSOVA

Dr.sci.Fadil Maloku/sociolog nga Prishtina

Në politikën globale, sot është e padiskutueshme tendenca e procesit të globalizimit, e cila si e tillë dalëngadalë por e sigurt është duke mbizotëruar kornizat e zhvillimeve dinamike politike në botë me qëllim të margjinalizimit sa me të mundshëm të formave tradicionale të organizimit dhe të menaxhimit të jetës së qytetarëve që i dalin asaj si pengesa serioze në galopimin e mëtejshëm të afirmimit. Në këtë kontekst, duket që as trendi i kompetencave të reja që burojnë nga vlera e diskursit të sovranitetit të shtetit që për globalistët është identifikuar si një "rezervat" i tipit të veçantë apo siç do të thoshte Aristoteli, një "zoom politikumi", nuk bëjnë ndonjë përjashtim karakteristik kur është në pyetje procesi i shtimit të interesave globale të tyre. Dilema më e madhe që u sjell sot sociologëve të globalizimit, kur janë në pyetje këto ndryshime marramendëse padyshim që kanë të bëjnë me rolin dhe perspektiven e institucionit të shtetit në të ardhmën. Për vendet e zhvilluara kjo dilemë deri diku është materializuar përmes formave të reja integruese, kurse për ata në zhvillim ende ka ngecje dhe ngurrime përsa i përket rolit të këtij institucioni në procesin e bartjes së një pjese të kompetencave (*lexo sovranitetit*) në forma të reja integruese rajonale.

Për kosovarët, të cilët për dallim prej të gjithë të tjerëve, natyra e trazimeve të brendshme kur është në pyetje ndërtimi i kapaciteteve të reja të institucionit shtet-komb, ka gjithandej specifika të cilat nuk mund t'i hasësh në asnjë model zhvillimor të procesit të ndërtimit të këtij institucioni në botë.

Në Kosovë, meqë është ende aktuale çështja e pretendimit të bërjes (jo e ridefinimit) së shtetit përgjithësisht në via të trasha, do të mund të identifikoheshin dy specifika cilësore që rrallëkund apo askund nuk mund t'i hasësh: specifikën e ndërtimit të infrastrukturës elementare demokratike dhe atë të realizimit të synimit për të ndërtuar këtë infrastrukturë elementare me mekanizmin e institucionit të sipërpërmendur. I cili për të tjerët ka filluar të pësojë ndryshime dhe modifikime të theksuara në vetë formën dhe përmbajtjen e vetë shkak i proceseve të reja të globalizimit. Nëse i adresohemi synimit të kahmotshëm të kosovarëve për ta ndërtuar këtë mekanizëm identifikues edhe për vetë identitetin e ri kombëtar, fitohet përshtypja që ky proces është identifikuar jo si nevojë e komoditetit

por e ekzistencës së qytetarëve të saj gjatë tërë shekullit të kaluar në kushtet dhe rrethanat e reja të një procesi tashmë të afirmuar si globalizëm, atëherë që padyshim lypset të kuptohen trendet e reja zhvillimore përreth. Kjo mënyrë e qasjes duhet involvuar edhe për shkak të vonësës së theksuar historike që e kemi pësuar jo me fajin tonë.

Është mirë pra që më në fund ka filluar të zgjidhet ky lëmsh rreth Kosovës dhe për Kosovën. Por a është kështu, do të pyeste ciniku?

Duhet theksuar parimisht që vlerat "klasike" (siç i kanë identifikuar shumica e sociologëve të sotëm), si ato që kanë të bëjnë me interesin kombëtar, integritetin territorial, me sovranitetin kombëtar e sidomos tash së fundi me sistemin e sigurisë kolektive, në botën përendimore nuk e gëzojnë më edhe gjithaq atë shkëlqimin apo rëndësinë që e kishin përpara, psh. në shek XIX-të kur edhe u afirmuan si vlera substanciale për rregullimin e raporteve mes qytetarëve dhe shoqërive.

Në aulat intelektuale, politike e sidomos ato kulturore në botë sot janë duke u zhvilluar debate të sofistikuar rreth këtyre formave dhe përmbajtjeve të reja të vlerave. Dilema kryesore tani për tani mbahet ajo që ka të bëjë me ambiguitetin apo interpretimin dualist që e fuqizojnë diplomatët dhe ekspertët e lëmive të ndryshme, në mënyrë që procesi i (ri)paisjes, si të themi me liçencën e mekanizmit të quajtur shtet të bëhet në qetësi dhe pa zhurmë të madhe në opinionin e gjërë. Natyrisht, një numër i madh sociologësh të njohur ende konsistojnë në qëndrimet arbitrare, se ende nuk ka ardhë momenti i (ri)paisjes apo zëvendësimit (apo edhe në variantën më të keq: reduktimit të menjëhershëm rolit të institucionit të shtetit në të ardhmen!) të këtij diskursi me ndonjë pseudoinstitucion tjetërfare. Për shumicën e tyre (si A. Giddens, Friedman, Beck etj.) institucioni i shtetit (jo edhe gjithaq ai i kuptimi modern, por ai klasik) është ende një mekanizëm i qëndrueshëm rregullues i jetës së njerëzve në mbarë globin.

Në Evropën e modelit të Unionit, pra në qarqet e eurokratike ekziston një projekt (në formë diskursi teknokrat) ende i pa afirmuar sa duhet për shumicën e vendeve të tranzicionit, se poqë se qytetarëve të këtyre vendeve u ofrohen më shumë të drejta qytetare (eufemizmi për të drejtat e njeriut) dhe më shumë paqe e qetësi kolektive, atëherë padyshim që çështja e sovranitetit të shteteve do

të mund të marginalizohet me lloj mekanizmin e sigurisë kolektive rajonale.

Në anën tjetër është poashtu e vërtetë që kapitalizmi i shekullit i identifikuar si globalizëm është duke instaluar një tip të ri apo një formacion të ri të shtetëzimit si mekanizëm më të drejtëpërdrejtë që duhet të ushtrojë pikësëpari menagjimin me të mirat dhe begatitë e një vendi. Ky tip, apo thënë më ndryshe, ky model nën ndikimin e unioneve të ndryshme monetare globale, fenomenit CNN, KTN-ëve, Internetit dhe OJQ-ëve, për shumicën e sociologëve të sotëm, deri tani nuk është duke dhënë rezultatet e pritura. Ai është duke falimentuar skajshmërisht si ide! Të përmendim vetëm rastin e refuzimit të francezëve për Kushtetutën e re Europiane!

Në rajonin e Ballkanit perëndimor, ku uria për identitetin shtetëror ende është e gjallë dhe një paranojë e llojit të vet edhe për faktin se për të janë zhvilluar madje edhe luftëra gjenocidiale, (shembulli i Bosnjës dhe i Kosovës) çështja e (ri)paisjes apo zëvendësimit të rolit të shtetit është e paimagjinueshme, e hershme dhe në shpërputhje me kohën e zhvillimit dhe të rumbullakimit të synimeve kolektive të kombeve. Ilthtarët e këtij koncepti në perëndim sot bëjnë ekspertiza dhe analiza të thukëta, duke fuqizuar mendimin akademik se çështja e (ri)paisjes apo reduktimi të sovranitetit shtetëror nuk ka qenë dhe nuk është diçka e re.

Ajo sipas tyre ka ekzistuar me të krijuarit e paradispozitave për të lindur ky mekanizëm, qysh në shekullin e XIX-të. P.sh. Amerika ka pasur përherë një lloj autonomie dhe kontrolli rigoroz ndaj kësaj çështjeje, bile edhe sot e bën këtë me xhelozinë më të madhe. Le të kujtojmë vetëm luftën që ajo zhvillon aktualisht në emër të terrorizmit, që kryekput kryhet në emër të këtyre idealeve dhe intereseve para së gjithash kombëtare që ajo i projekton në gjithë rruzullin tokësor.

Thënë me thjeshtë sovraniteti edhe sot e kësaj dite ka mbetur tërheqës për shumicën dominuese të vendeve të zhvilluara dhe atyre që janë në zhvillim, duke mos folur për ata që janë në procesin e tranzicionit dhe të procesit të shtet-formimit, siç është rasti i Kosovës, ku interesimi mobilizues i qytetarëve të saj lidhur me dëshirën dhe pasionin e tyre shekullor për të pasur një shtet të vetin e ka burimin shpjegues dhe shumë identik me popujt e tjerë përreth.

Pra, ideja e një sovraniteti të plote të shtetit të ri të Kosovës anipse parë me dioptrinë e një eksperimenti të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk e ka peshën e mëtejme se të një njohjeje formale

ndërkombëtare në akusherin e OKB-së, ku edhe (de)legjitimohen sovranitetet e shteteve, përmes të cilës pastaj thithja e begative materiale dhe atyre financiare bëhet më e lehtë dhe më durueshme, ajo prapseprap e ka madhësinë vetë identifikuese. E, kjo madhësi nuk është edhe gjithaq ideale ashtu siç është projektuar zakonisht në kokat e masave të gjera popullore, por para së gjithash pragmatike, ngaqë institucionet dhe qytetarët e mbarë rruzullit tokësor transaksionet e tyre të ndryshme ende i ushtrojnë pikërisht përmes këtij mekanizmi anipse ai herë pas herë gjatë qenësimit të vet të gjertanishëm historik ka ditur të gjenerojë autoritet dhe arbitraritet të pakontestueshëm dhe një lloj egalitarizmi të diskutueshëm.

Duhet përmendur kalimthi, se në kohën kur Zhan Boden dhe Tomas Hobsi, për herë të parë filluan të përpunojnë idenë e vëllimit të sovranitetit të shtetit në shek. XVI-të dhe XVII-të, rolin e tij e kishte "uzurpuar" e drejta hyjnore për të cilën u zhvilluan luftëra të përgjakshme. Për këta autorë çështja e sovranitetit ishte një sinonim i ligjësisë dhe i një rregulli të veçantë, ku të nënshtruarit nuk kishin asfarë të drejte të rebelohen, mirëpo më vonë kuptuan se ky absolutizim i tepruar i sovranitetit mund të çojë dashur e padashur shoqërinë në tirani (gjë që ngjau shpesh gjatë historisë së njerëzimit) dhe në despotizëm të patolerueshëm.

Por çfarë kuptimi ka sot në kohën tonë diskutimi mbi sovranitetin?

Ai, të themi kushtimisht ka filluar të luhetet me mbarimin e luftës së ftohtë dhe me fillimin e ndërimit të rendit të ri botëror të identifikuar si globalizim, uesternizim apo edhe amerikanizim.

Ideja e sovranitetit, poashtu ndërlihet shumë edhe me Paqën e Westfalisë (1648) që është e njohur si marrëveshje historike (në të vërtetë e dy marrëveshjeve: asaj të Minsterit dhe asaj të Osna-bryckut), ku u krijuan predispozitat e para për një sistem modern të shteteve të pavaruara në Evropë. Në të vërtetë, kjo marrëveshje më shumë i adresohet çështjes që kishte të bënte me delegjitimitetin hegjemonist të Kishës së shenjtë katolike të njohur si perandori e llojit të vet, se sa të idesë se marrëdhëniet ndërkombëtare duhet t'i lëvizë parashikimi lidhur me barazpeshën e fuqisë midis vendeve.

Poashtu, një ndër provokimet më të rënda që i është bërë ndonjëherë diskursit të sovranitetit padyshim, që ka të bëjë me të drejtat universale të njeriut në gjithë globin tokësor. Përmes këtij diskursi, sot mekanizmat ndërkombëtare si OKB-ja kanë të drejtën e ndërhyrjes moralopolitike (rezolutat e aprovuara), por jo gjithëkund dhe gjithë-

herë edhe të drejtën e ndërhyrjes ushtarake, siç ishte rasti i Kosovës. Ndryshimet e fundit marramendëse tekniko-teknologjike kanë bërë që, në një mënyrë e kanë thyer, si të themi atë barrierën e shteteve sovraane. Ngaqë ndikimi i mediave globale (rasti i gjigantit të quajtur CNN dhe Alxhazira) kanë bërë që të mos mbetet me asgjë nën mëshirën e pushtetmbajtësve lokalë. Sot pra si interes kombëtar i një vendi nuk janë mbyllja dhe izolimi por përkundrazi hapja dhe demokratizimi i brendshëm i raporteve shoqërore, pra ndërtimit të një diskursi më të përsosur të qeverisjes dhe menagjimit me qytetarët e cilitdo vendi, ku institucionet legale të dalur nga zgjedhjet funksionojnë në mënyrë të admiruar.

Roli i shteti të ardhshëm me siguri që do të anojë më tepër kah roli i menagjimentit ashtu siç ka filluar aktualisht në perëndim. Por pyetja se si do të mund të afirmohet çështja e sovranitetit të cinguar ("autonomi substanciale") apo atij të reduktuar ("pavarësi e kushtezuar") në kushtet dhe rrethanat e reja të procesit të globalizimit, siç është rasti me Kosoven mbetet për t'u parë. Ngaqë, sot për sot është një çështje që ende nuk ka arritur të ketë ndonjë përgjigje të pranueshme as nga diskursi politik e as nga ai shkencor.

Së këndejmi çështja e reduktimit të sovranitetit duket se ende është në fazën eksperimentale dhe një Eldorado e vërtetë, ndërsa mjedis më të përshatshëm se Ballkani për këtë veprim prokrustian, duket që ende nuk ekziston.

Në fakt, mbetet një nevojë që ka të bëjë thelbësisht me ndërtimin e institucioneve të pakorruptuara, përmes të cilave do të rritej vetëdija racionale për veçantinë e posaçme, si vlerë e procesit të globalizimit.

Edhe pse modeli i komb-shtetit, për disa është bërë një pengesë serioze në fuqizimin e arkitekturës së integritimeve globale, prapëseprapë do thohja se ai nuk mjafton vetëm të marginalizohet dhe si i fillë të bartet në muzeun e traditacionales edhe për shkak se ende nuk ka ndonjë mekanizëm tjetër që do ta zëvendësonte atë si të fillë. E çka është edhe më interesante, korniza e shtet-kombit, tash për tash mbetet e vetmja shpresë dhe i vetmi identifikim (që meriton edhe të sakrifkohet për të) përmes të cilit mund dhe po ndërtohet aktualisht demokracia si diskurs botëror. Nga ana tjetër, çështja e (jo)reduktimit, nuk është edhe gjithaq çështje e realizimit apo mosrealizimit të synimit për të menagjuar me vetëvehten si shoqëri e re demokratike, sa çështje e zhvillimit të aspekteve social-ekonomike të qytetarëve të vendeve të tranzicionit, aty ku aktualisht e ka vendin edhe Kosova.

Pra, roli i shtetit në kushtet dhe rrethanat e reja është një domosdoshmëri e llojit të vet, ngaqë vendet e tranzicionit ende nuk e kanë perfeksionuar sa duhet zëjën e menagjimit me vetëvehten. Institucioni i shtetit gjithashtu është duke përjetuar një krizë do të thoshja tridimensionale, sidomos kur janë në pyetje sferat e kompetencave të tij si institucion i fortë në menagjimin e të mirave materiale të qytetarëve të vet.

Argumenti i parë i kësaj krizë, është duke u manifestuar në sferën e ekonomisë dhe të politikës, ku ai një pas një është duke pësuar humbje në kuptimin e privimit nga disa ndërhyrje që i ushtronte më heret. KTN-të (Kompanitë Trans Nacionale) për shumicën e sociologëve të sotëm thuhet se janë ato që në një farë menyre kanë tendenca t'i zëvendësojnë në këto sfera disa kompetencat e shtetit klasik. Kësaj tendence thuhet që as SHBA-ja, nuk po mund t'i shpëtojë, e cila më së miri u pa me rastin e pushtimit të Irakut.

Argumenti i dytë, për krizën e dukshme të institucionit të shtetit tani dhe në të ardhmën, thuhet që është padyshim ekzistenca e një vullneti dhe një dëshire globale politike, për ta ndërruar procesin e zhvillimit të kapitalizmit. Duke mos hyrë në një analizë më të thellë, vlen të përmendim bie fjala, zotërimin e elitave pushtetmbajtëse të botës perëndimore, sidomos asaj amerikane, angleze, spanjolle, italiane etj. P.sh. në një takim të Komisionit trilateral, D. Rockefeller, përndryshe kryetar i kësaj shoqate, ka thksuar se: "Pushteti mbinacional i bankierëve dhe i elitës intelektuale ndërkombëtare, duhet të qëndrojë mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje" (!?). G. Soros, njëri ndër zëdhënësit më të fuqishëm të globalizmit politik, procesin e kontrollit të tregut global e sheh vetëm në ndërtimin e institucioneve mbinacionale.

Argumenti i tretë, i krizës së ashtuquajtur shtetërore ka të bëjë me humbjen e cilësisë së rolit të tij në formimin e të ashtuquajturit ethos kombëtar, që sipas Giddens është pasojë e rritjes së "vetëdijes kozmopolite". Me sa mund të hetohet, shumica e sociologëve janë të mendimit se roli i shtetit në rrethanat e reja të globalizmit domosdoshmërisht do të reduktohet, përkatësisht, do të zbehet sovraniteti i tij, mirëpo ai asnjëherë tërësisht nuk do të mund të zëvendësohet me ndonjë mekanizëm tjetër. Dilema jonë është nëse Kosova, që e pret sfida e përcaktimit të statusit politik, është apo nuk është në rrugëtimin e proceseve të lartpërmendura? Përgjigjen le ta japin politikanët aktualë në fuqi gjatë këtij mandati të qeverisjes historike!

MATEMATIKANE T SHQIPTARE SE BASHKU NE INTERNET

Po të shkoni në lidhjen e mëposhtme elektronike:

http://personalwebs.oakland.edu/~shaska/ulonna/complete_list.html

do t'ju hapet faqja e përgatitur nga Dr. Tanush Shaska, Profesor në Universitetin e Oakland-it, Michigan, Amerikë, e cila përmban një listë me të gjithë ata matematikanë shqiptarë të cilët kanë botuar qoftë edhe një artikull të vetëm shkencor. Si kriter i vetëm i kësaj liste është që artikulli të jetë bërë "review" në MathSciNet (<http://www.ams.org/mathscinet>) ose në Zentralblatt MATH (<http://www.emis.de/ZMATH>). Nëqoftese dikush tjetër ka botuar artikuj

shkencorë që kanë të bëjnë me matematikën dhe përlogaritjet dhe nuk është renditur në këtë listë atehere ju lutemi të kontaktoni me Dr. Shaskën (shaska@oakland.edu).

Ky informacion është afishuar gjithashtu edhe në Seksionin e Matematikës dhe Statistikës në faqet e Alb-Shkencës në internet (www.alb-shkenca.org).

Për një përshkrim të detajuar të punës së këtyre matematikanëve shihni versionin e parë të librit *Matematika shqiptare* që do të dalë në botim në mars 2006.

Më poshtë lista me emrat e matematikanëve shqiptarë të përmendur për punimet e tyre:

1. Baxhaku, Artur,
2. Bukuroshi, Kristian,
3. Cakoni, Floralba,
4. Çela, Eranda,
5. Dollani, Helidon,
6. Elezi, Artur,
7. Fundo, Kristaq,
8. Fundo, Mishel,
9. Gjini, Nertila,
10. Gjinushi, Skënder,
11. Gjonaj, Erion
12. Hashorva, Enkelejd,
13. Hoxha, Parid,
14. Hoxha, Razim
15. Kastrati, R.
16. Kraja, Osman,
17. Kume, Alfred,
18. Minga, Aleko,
19. Pasku, Elton,
20. Pepo, Burbuqe,
21. Petro, Petraq,
22. Pilika, Petraq,
23. Puka, Llukan,
24. Rexhepi, Vlora,
25. Shaska, Tanush,
26. Shehu, Islam,
27. Shkodra, Sadri,
28. Velo, Ani,
29. Xhemalçe, Sulejman,
30. Zejnullahu, Ramadan

Jetojmë në një univers apo në një multivers?

Kostantet universale si shpejtësia e dritës apo ajo e gravitetit universal ndoshta nuk janë kaq kostante e universale. Kjo hipotezë mbështetet prej kohësh nga fizikani teorik Leonard Susskind, në Universitetin e Stanfordit (Kaliforni), dhe nga ideatorët e teorisë së lidhëseve, por së fundi po zgjon më shumë interes në komunitetin shkencor ndërkombëtar.

Libri i ri *Cosmic Landscape: String theory and the illusion of intelligent design*, ilustron aspektin qendror dhe revolucionar të vizionit të Susskindit: konceptin e multiversit.

Sipas tij dhe ndjekësve të tij, universi ku jetojmë është vetëm një pjesë e vogël e një "multiversi" e në secilën nga këto "pjesë" kostantet e ashtuquajtura universale nuk janë të njejta.

Pika e dobët e kësaj teorie tërheqëse ka qenë gjithmonë verifikimi eksperimental: ka shumë

pak mundësi që të njihet një univers ndryshe nga i yni e në mungesë të të dhënave teoria e multiversit i ngjan më shumë një spekulimi metafizik sesa një hipoteze shkencore.

Por, sipas Susskind, një detaj në favor të teorisë së tij mund të jetë shumë i afërt: nëse përlogaritjet e bazuara tek vëzhgimet astronomike do të tregojnë se curbatura e hapësirës është negative (d.m.th. nëse hapësira nuk është as e shehtë as sferike), atëhere koncepti i multiversit do të jetë më i pranueshëm për fizikanët. Në këtë rast do të kishim edhe një humbje për mbështetësit e teorisë së Intelligent Design, versioni i krijimit të njeriut nga një qenie hyjnore.

Përndryshe nuk do të ketë asnjë provë mbështetëse të multiversit, i cili do të mbetet ende një teori në pritje për informacione të reja.

New Scientist

TROKET SHQIPERIA E NESERME

SKENDER SHKUPI

Artikulli i mëposhtëm trajton problemin e "korridorit të tetë" dhe përfitimet që do të ketë Shqipëria nga ndërtimi i kësaj arterieje rrugore. Është shumë interesant fakti që të dy partitë që kanë qeverisur vendin këto 15 vjetët e fundit kanë qendrimet diametralisht të kundërta rreth kësaj çështjeje. Pyetja që mund t'i shtrohet auditorit të profesionistëve të Alb-Shkencës mund të jetë se cili është qendrimi më i drejtë që vërtet ndihmon në zhvillimin dhe fuqizimin e Shqipërisë.

Mendoj se do të ishte me shumë vlera po të dëgjonim opinionet e atyre që studiojnë ekonomi apo gjeopolitikë rreth kësaj teme që me sa duket përbën boshtin e politikës së jashtme të qeverisë së re shqiptare.

Më poshtë mund të lexoni artikullin e zotit Skënder Shkupi, anëtar i Alb-Shkencës, të botuar para disa ditëve. Zoti Shkupi është autor i një libri të botuar sivjet në New York, me titull "Aventurat e politikës dhe Korridorit 8". Në të ka një kapitull mjaft të gjerë vetëm për problemet e kësaj arterieje të madhe. Ai ka botuar në Tiranë gjithashtu një studim në anglisht e shqip me titull "Gjeopolitika e Korridorit 8". Ky studim përfshihet në librin e lartpërmendur. Kopje të librit në fjalë mund ti kërkojnë drejtpërdrejt nga autori kundrejt çmimit modest \$10 (s_shkupi@yahoo.com).

Niko Qafoku

Ridalja në vitrinën e politikës së madhe, ballkanike e evropiane njëherësh, të një përparësie të mohuar padrejtësisht, të ndërtimit të Korridorit 8, është më tepër se një lajm i gëzueshëm për miliona shqiptarë anekënd botës. Ndofta në Shqipëri nuk janë të shumtë ata që e perceptojnë realisht rëndësinë kolosale të një projekti të tillë për të ardhmen. Kjo përshtypje mbështetet në konstatimin e hidhur që gjatë tetë viteve të qeverisjes socialiste Shqipëria zyrtare nuk e mori kurrë sa duhet seriozisht angazhimin e domosdoshëm që kërkonte ky projekt madhështor që përbën hapin vendimtar të daljes së vendit nga varfëria dhe mjerimi i sotëm. Qeveritë shqiptare të periudhës '97-05 bënë përpjekje të vakëta që shkuan deri në indiferentizëm për sensibilizimin e BE-së ndaj projektit në fjalë. Me sa duket ndërmjet përfitimit tonë ndaj realizimit të projektit të madh të Korridorit 8 dhe marrëdhënieve tejet të ngrohta me Greqinë fqinjë Tirana, e tetë viteve që shkuan, preferoi variantin e dytë.

Tashmë nuk është sekret se Athina është kategorikisht kundër ndërtimit të këtij korridori. Arsyet janë kryesisht ekonomike por që parathënë edhe rrjedhoja të rëndësishme në fushën politike. Ndërtimi i Korridorit 8 është jo vetëm i lidhur me prosperitetin e shpejtë të Shqipërisë (nga vlerësimet paraprake del se përfitimi fillestar vetëm nga transporti i mallrave në këtë linjë është diku rreth 450 milionë dollarë) por nga ana tjetër e bën Tiranën faktor të politikës ballkanike e evropiane njëherësh. Është pikërisht kjo rrethanë që ngjan jo thjesht e papranueshme por deri e pakonceptueshme për planifikuesit e strategjive politike në Athinë. Greqia aspiron të bëhet Gjermania e Ballkanit ndonëse ky oreks kaq i madh nuk i përshtatet stomakut të saj. Ndërtimi i Korridorit 8 e le Greqinë disi mënjane trafikut të madh nga Lindja e Mesme drejt Evropës Jugore dhe Mesdheut, prandaj të gjitha energjitë e saj u përqëndruan, dhe jo pa sukses, në sabotimin e projektit të kësaj arterieje të rëndësishme të Evropës Juglindore. Rezultati i përpjekjeve kolosale të Greqisë, kombinuar me sabotimin e heshtur të qeverive shqiptare, është i njohur: vendimi i vitit 2003 për ta lënë të shqyrtohet projektin e Korridorit pas 2020-ës (!).

Risfaqja e interesit evropian për Korridorin 8, me sa duket, është ndikuar edhe nga ndryshimet politike të ndodhura në Shqipëri më 3 korrik 2005. Ardhja në qeveri e një formacioni politik që natyrshëm, ndërmjet Korridorit 8 dhe përfaqimit të nxehtë me fqinjin tonë jugor, preferon të parin, është një faktor jo pa rëndësi edhe në hapat e hedhur nga vendimmarrësit evropianë. Mirëpo thjesht brohoritja dhe përsëritja e një vendimi të tillë nga qeveria shqiptare nuk mjafton. Duhet një angazhim i plotë i të gjitha strukturave të shtetit tonë për ta nxitur, mbështetur e përshtetur këtë projekt që, për ne, përfaqëson zgjidhjen e shumëkërkuar të problemit të varfërisë së thellë të shqiptarëve.

Ka pasur tendenca, në të kaluarën, për ta paraqitur Korridorin 8 thjesht si një projekt rruge, me interes vetëm për zonat nga kalon ai. Si rrjedhojë e një konceptimi të tillë naiv e vulgar, krahina relativisht jo pranë atij korridori sugjeronin variante alternative nga duhet të kalonin arteriet rrugore shqiptare në të ardhmen. Një këndvështrim i tillë dëshmonte se sa pak ishin të ndërgjegjësuar shqiptarët për kuptimin dhe rëndësinë e kësaj

vepre të pakrahasueshme për nga përmasat ekonomike dhe rrjedhojat politike ndaj çdo realizimi tjetër në Shqipëri. Në të vërtetë Korridori 8 është diçka shumë më e madhe se një autostradë e thjeshtë. Ai përfaqëson një bosht gjeopolitik shumë të rëndësishëm jo vetëm për Evropën Perëndimore por, për fatin tonë të madh, edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kurse në rrafshin konkret po rikujtojmë të dhëna që tashmë janë përsëritur shpesh edhe nga specialistë të ndryshëm që nga janari i vitit 1998 kur nisi veprimtarinë e saj "Shoqata për sensibilizimin e opinionit shqiptar për Korridorin 8" e deri sot: Korridori 8 përmban një autostradë që detyrimisht duhet të kalojë nga Tirana, pra Durrës-Tiranë-Elbasan-Qafë Thanë-Shkup-Sofje- Varna (një shtesë fare e vogël mund ta lidhë me autostradën që shpie në Stamboll, duke bërë të mundur komunikimin rrugor me vendet e Lindjes së Mesme), një linjë hekurudhore dykalimshe të elektrifikuar, naftë dhe gazsjellës, linjë të fibrave optike, shoqëruar me morinë e aksesorëve të domosdoshëm për ta mbajtur në këmbë këtë strukturë gjigante, uzina prodhimi materialelesh inerte, fabrika tullash e betoni, magazina, hotele, motele, restorante, nyje furnizimi me karburant, mjedise çlodhjeje etj. Është një kompleks i tërë industrial në shërbim të Korridorit 8 që do të sjellë një gjallëri të paparë në të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë ai korridor do të bëjë të mundur një afrim më të madh ndërmjet vendeve që do t'i përshkojë pra Shqipërisë, Maqedonisë e Bullgarisë jo vetëm në aspektin kulturor që është mjaft i rëndësishëm për Ballkanin por edhe në atë politik. Por mbi të gjitha përfitimi ekonomik i të tre vendeve të lartpërmendur do të jetë i jashtëzakonshëm. Ai do të shpjerë, me siguri, në zvogëlimin progresiv të diferencave në nivelin e jetesës ndërmjet Greqisë dhe fqinjëve të saj të Veriut duke i dhënë fund emigrimit të detyruar të banorëve fatkeqë të atyre vendeve drejt Jugut. Për Shqipërinë nuk do të jetë e largët dita kur emigracioni ekonomik do të kthehet në një fakt historik të së kaluarës duke çliaruar qeveritë e ardhshme shqiptare nga ankthi i zëmërimit të mundshëm, me rast e pa rast, të luanit të vogël grek.

Janë për t'u përshëndetur lëvizjet e z. Berisha drejt Italisë javët e fundit. Këto lëvizje dëshmojnë për një konceptim të drejtë të interesave jetësore të Shqipërisë në marrëdhëniet me fqinjët. Në të vërtetë, një ndihmë të çmuar i kanë dhënë zotit Berisha edhe politikanët e Athinës të cilët, të mësuar me demonstrim madhështie dhe epërsie ndaj kolegëve të tyre shqiptarë gjatë tetë viteve që shkuan, harruan se në Tiranë diçka ka ndryshuar

qysh nga vera që lamë pas. Formula se "shqiptarët, çfarëdo që t'u bëjmë përsëri do të na përulen", me sa duket nuk po funksionon më.

Nëse politikanët me përvojë të gjatë të Greqisë do ta kuptonin se jo të gjithë shqiptarët marrin frymë vetëm me aq oksigjen sa u servir Athina, atëhere do të kishin shmangur incidentet qesharake siç ishte ai i anulimit të takimit me të zotin e shtëpisë kur je futur brenda shtëpisë së tij. Ndërkohë z. Karamanlis do të linte dikë tjetër për dy-tri ditë të merrej me problemet e buxhetit të vitit të ardhshëm e do të vraponte në Tiranë për t'u takuar me z. Berisha. Mirëpo, me sa duket, për fatin e shqiptarëve, z. Karamanlis e ka lënë për fundin e janarit vizitën e tij zyrtare në Shqipëri.

Është me vend të shtojmë se, në asnjë rrethanë, këmbëngulja jonë për ndërtimin e përshpejtuar të Korridorit 8, nuk nënkupton detyrimisht keqsimin e marrëdhënieve tona me Greqinë. Shqipëria ka interesa të mëdha për të vazhduar një politikë miqësore e bashkëpunimi me Athinën për shumë arsye që është e tepërt të përmenden këtu. Megjithatë, përparësia është përparësi. Të gjithë janë të ndërgjegjshëm që në përzgjedhjen apo përparësinë e marrëdhënieve kur flitet për dyshen Itali-Greqi, jashtë çdo diskutimi, peshorja do të anojë nga Italia. Dhe kjo për shumë arsye. Italia zë vendin e pestë gjashtë në botë kurse Greqia në 15-shen klasike të BE-së është e fundit. Në Itali ka shqiptarë të cilët prej më shumë se 500 vjetësh formojnë një komunitet të dallueshëm e të paasimiluar nga vendasit, me shkollat, kishat e klubet e tyre. Në Greqi edhe arvanitasi që flet shqip, me zë të lartë thotë se është grek. Dikush nga dëshira por shumëkush edhe nga frika. Në Itali nuk ka arbëreshë të dëbuar nga trojet e tyre apo të masakruar për motive të stisura. Në Greqi mbetet i hapur problemi i të dëbuarve çamë të ndjekur, të masakruar e të grabitur në mënyrën më çnjerëzore të mundshme. Së fundi, në Itali nuk ka shoqata që të kërkojnë me zjarr Vlorën dhe Sazanin ndërkohë që në Greqinë fqinje melodia monotone e Vorio-Epirit është kthyer në një kafoni acaruese edhe për veshët e evropianit më dashamirës ndaj grekëve të vjetër e të rinj. Mjaftojnë këto kontraste për të vendosur. Dhe me sa duket qeveria e re shqiptare ka gjetur zgjidhjen e duhur. Na mbetet të besojmë se ajo do të jetë konseguente në rrugën e nisur.

Botuar edhe në gazetën "Shekulli", 10 dhjetor 2005

Mjeda (Bashkëkohësit)

Mentor Quku,
vëllimi 7,
Shtëpia botuese Ilar,
Tiranë, 2005

Pas librit *Mjeda-1 (Rinia)*, autori paraqitet me vëllimin e ri *Mjeda-7 (Bashkëkohësit)*. Është libri i dytë i serisë kushtuar Ndre Mjedës. Janë edhe pesë vëllime të tjera që autori Mentor Quku premton ti botojë së shpejti: *Mjeda-2 (Shkencëtari)*, *Mjeda-3 (Atdheu)*, *Mjeda-4 (Politikani)*, *Mjeda-5 (Pleqëria)*, *Mjeda-6 (Bibliografia)*.

Në një fazë të dytë autori ka planifikuar katër vëllime të tjera: *Mjeda-8 (Vepra, poezia)*, *Mjeda-9 (Vepra, proza)*, *Mjeda-10 (Vepra, studime)* dhe *Mjeda-11 (Album)*.

Tek vëllimi i sapo dalë në qarkullim *Bashkëkohësit*, autori përmes gojës së bashkëkohësve të Mjedës, hyn thellë në zemrën e ngjarjeve dhe të jetës së tij, për t'ia paraqitur lexuesit në mënyrë që gjithçka të duket në vërtetësinë, me hijet e me dritat e veta.

N.q.s. libri i parë merret me rininë e Mjedës, ky i shtati ka një orientim krejt të ndryshëm sepse qëllimi i tij është paraqitja e një Dom Ndreje të dalur prej përshtypjeve e mendimeve të një morie njerëzish të cilët kanë patur rastin ta njihnin atë. Ky ka qenë një shestim krejt i posaçëm i autorit. Ndryshe prej shumë botuesve e studiuesve të veprave të autorëve tanë të shquar, është kapur tek një aspekt krejt i veçantë për të studiuar personalitetin e një figure të madhe letrare e historike. Ka qenë një ide krejt origjinale dhe ka më vleftë edhe për ata studiues që do merren me studime të ngjashme.

Dhe nuk është, një punë e thjeshtë dhe e lehtë. Është dashur për të ndjekur e gjurmuar një numër të madh personash, kur ata ishin ende gjallë. Mandej për t'i intervistuar, duke nxjerrë prej secilit njoftime të dorës së parë, të cilat kanë një vlerë të pakrahasueshme për të kuptuar më mirë një personalitet poliedrik si Mjeda.

Mentor Quku këtë e ka bërë duke pasqyruar kujtimet që bashkëkohësit mbanin në mendjet e zemrat e tyre. I ka dhënë fjalët e tyre në sintezë, pa i mbushur me fjalë kote, por duke i paraqitur në mënyrë lakonike, në thelbin e tyre. Kështu pa stërhollime, na del para një Dom Ndre i thandruem më së miri, si, deri më sot, pak kush ka mundur ta imagjinojë.

Pjesën më të madhe të tekstit, të përfaqësuar prej intervistave, e plotëson më në fund riprodhimi i disa shkimeve kushtuar Dom Ndreut në trajtën e portreteve, e kujtimeve e të njoftimeve të nxjerruna prej autorësh e veprash të ndryshme të të gjitha kohëve.

Bashkëkohësit sikur janë vënë në radhë, dhe nguten kush e kush të flasë më parë. Janë nxënës të tij, që heqin kapelen me nderim para mësuesit të tyre, që krenohen se kanë biseduar me të, kanë dëgjuar fjalën e tij. Nxënës të tjerë që e falënderojnë atë, mësuesin Ndre

Mjeda, që më vonë u bënë poetë, gjuhëtarë, përkthyes e shkencëtarë. Kolegë të tij, gazetarë, shkrimtarë dhe gjuhëtarë të huaj që, në unison, thonë me plot gojën, madje disa me habi se këtu në Shqipërinë e vogël dhe pak të njohur gjetën një njeri shumë të madh, një njeri të kompletuar, një poliglot, një erudit, para të cilit përu-len me respekt dhe me sinqeritet.

Pastaj renditen ata, më të shumtit, urdia e njerëzve të thjeshtë, hallexhinjtë, njerëzit e lidhur përjetësisht me tokën. Fjala e tyre është e ashpër si vetë jeta e tyre. Fjala e tyre nuk ka "ojna", retorikë, stërhollim apo alegori. Ata, njerëzit e thjeshtë, ata, bujqit e barinjët, që janë të shumtë dhe bëjnë pjesën më interesante, dhe, mendoj unë, pjesën më të vyer të këtij vëllimi. Ata nuk ngopen së foluri. Sepse i kanë të ngulitura në mendje dhe në zemër si kujtime që do t'i bartin me vete gjer në varr. Madje, do t'i kishin marrë me vete, pa na i bërë të njohura neve, po të mos ishte qëmtimi, durimi dhe pasioni prej shkencëtari i Mentor Qukut që ua mori këto kujtime për të mos u shuar, për të mos u varrosur, por që të shërbejnë jo vetëm si ngjyra, por edhe si penel për të bërë portretin e madh të një njeriu të madh, për të skaltur përjetësisht jetën e një njeriu shumë tokësor. Të gjithë ata, njerëzit e thjeshtë që e kanë njohur Mjedën dhe tregojnë kujtimet që kanë prej tij, thonë se ai ishte një bujk i lindur, një fermer me përmasa moderne për kohën. Dhe, si në një roman biografik, e shohim Mjedën, përmes këtyre kujtimeve, të sjellë në katund, për vete dhe për katundin, vegla bujqësore moderne, plehra kimike dhe t'i bindë fshatarët e tij për dobinë e përdorimit të tyre. Pastaj të eksperimentojë mbjelljen e ullinjve në shkëmbinj, të bindë e pastaj të mobilizojë bujqit për të çelur kanale kulluese që të shpëtojnë tokat nga përmbytja, të provojë mbjelljen e grurit në pranverë, t'i mësojë bujqit si të ruhet dhe si të desinfektohet fara, me një fjalë, t'i bëjë të ndërgjegjshëm se duhet ecur me kohën edhe në punët bujqësore. Po si në një roman, e shohim Mjedën rrethuar nga macet e tij që ashtu si arusha e tij, bëhen personazhe që rrethojnë jetën e tij të përditshme. E shohim të bëjë përpjekje titanike, mbi-njerëzore, që të mos e lërë të shuhet një fshat, të cilin, ndër mote, e kishin mbuluar sëmundjet vdekjeprurëse, epidemitë shfarosëse. E shohim të ndihmojë, me gjithë shpirtin e një bujari dhe me devotshmërinë sublime të një prifti, njerëzit në nevojë, duke u dhënë me qera toka dhe konak, madje edhe duke ua falë atyre ato. Dhe, si një refren i bukur, njerëzor, shumë domethënës, duke u marrë qeraxhijve vetëm një kallë misri për çdo dym, hak sa për të mos u thënë apo fyer ata se ua ka falur.

Pasi e ke lexuar me kujdes dhe me kureshtje e dëshirë këtë libër, bindesh edhe për diçka tjetër shumë të rëndësishme: Nga goja e shpirti i njerëzve bashkëkohës del një Mjedë me një dëshirë dhe një dashuri që përjetësisht i djeg shpirtin: Dashuria për atdhe.

Begzad Baliu

Endërrime që u bënë realitet

(Biografi të individëve që kanë mbaruar studimet në vendet evropatlantike)
 Publikim i Ministrisë së Arsimit të Kosovës (MASHT), Prishtinë, 2005

Këtë vit doli nga shtypi publikimi i Ministrisë së Arsimit të Kosovës (MASHT), me titullin e mësipërm. Publikimi në fjalë ka 256 faqe dhe përmban 86 biografi, shumica në gjuhën shqipe dhe anglisht ose gjermanisht. Fjala është për individë të cilët kanë kryer studimet universitare, pasuniversitare apo specializime të ndryshme jashtë Kosovës (shumica në Austri, Gjermani, Zvicër, Angli, Suedi etj.). Çdo biografi shoqërohet me një rezumë (Summary), prej tri faqesh, në gjuhën anglishte dhe gjermanishte.

Publikimi ka një parathënie si dhe një historik të shkurtër të arsimit shqip në përgjithësi dhe të arsimit në Kosovë, si edhe të dhëna statistikore përkitazi me kandidatët e përfshirë në të. Përfshihen dhe të dhëna për magjistrat dhe doktorët e shkencës në Kosovë gjatë periudhës 1945-2003, shumica prej të cilëve janë mësimdhënës dhe punonjës shkencorë në Universitetin e Prishtinës dhe në institutet shkencore në Kosovë.

Vlen të përmendet se ndër individët biografite e të cilëve janë në publikim, ka edhe të tillë që kanë arritur rezultate arsimore, shkencore e kulturore, që i bëjnë nder edhe shkencës evropiane.

Publikimi është frymëzues për të rinj që kanë ambicie të studiojnë ose specializohen në fusha të ndryshme në universitete prestigjioze perëndimore, ashtu si kanë arritur individët e përmendur në këtë vëllim.

Libri kushton 5 euro (plus shpenzimet e postës). Në Prishtinë mund të gjendet në librarinë pranë Institutit Albanologjik apo në librarinë e Ndërmarrjes Botuese "Dukagjini", që gjendet në rrugën "Nënë Tereza", përballë hotelit "Iliria". Mund të porositet edhe përmes postës elektronike: zenunr@hotmail.com ose ceni07@yahoo.com.

Begzad Baliu

Poultry Nutrition and Feeding

(Ushqimi dhe të ushqyerit e shpendëve)
 G.M. Pesti, R.I. Bakalli, J.P. Driver,
 A. Atencio, E.H. Foster
 Trafford Publishing
 ISBN 1-4120-7536-X
 Libri ka 4449 faqe
 Çmimi: \$60.00, 49.29 euro

Kam kënaqësinë t'ju njoftoj që këto ditë doli nga shtypi teksti me titull "Poultry Nutrition and Feeding", njeri nga autorët e të cilit është edhe shkencëtari shqiptar Prof. Remzi Bakalli.


Prof. Dr. Bakalli, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, është një shkencëtar i shquar në fushën e shkencave të prodhimtarisë shtazore. Z. Bakalli ka punuar shumë vjet si Profesor në Universitetin e Prishtinës, ku pata nderin e madh të jem student dhe më vonë edhe bashkëpunëtor i tij.

Veprimtarinë e tij shkencore Prof. Bakalli e zhvillon aktualisht në Universitetin e Georgia-s, në Athens të SHBA-së. Rezultat i këtij aktiviteti shkencor është teksti që po ju paraqesim si dhe një numër i madh punimesh origjinale shkencore nga fusha e të ushqyerit dhe toksikologjia, të publikuara në revista të ndryshme si: *Poultry Science*, *Bull. Environ. Contam. Toxicol.*, *Veterinary and Human Toxicology*, *The British Journal of Nutrition*, *British Poultry Science* etj.

Ndërkaq më shumë për këtë libër i cili është shkruar për studentë dhe për specialistë që merren me të ushqyerit e shpendëve mund të lexoni në faqet elektronike të shtëpisë botuese Trafford:

<http://www.trafford.com/4dcgi/view-item?item=10854>

Bajram Berisha



ISO-POLIFONIA POPULLORE SHQIPTARE “KRYEVEPËR E TRASHËGIMISË GOJORE TË NJERËZIMIT” E MBROJTUR NGA UNESCO

VASIL TOLE

Pa më të voglin dyshim, data 25 nëntor 2005 është një ditë historike për mbarë trashëgiminë kulturore të shqiptarëve por dhe për vetë Shqipërinë. Në këtë ditë iso-polifonia popullore shqiptare futet në listën e kryeveprave të trashëgimisë gojore të njerëzimit mbrojtur nga Unesco, fakt që u kumtua në të gjitha mediat e botës nga Dr. Koichiro Matsura, Drejtor i Përgjithshëm i Unescos-s, nga selia qendrore e kësaj organizate në Paris. Për të dale me këtë vendim, juria ndërkombëtare e mbledhur në kryeqytetin francez nga data 21-24 nëntor 2005, shqyrtoi mbi 60 kandidatura të propozuara për t’u përfshirë në listën “Kryevepër e njerëzimit”, propozime të bëra në rrugë zyrtare nga shtete të ndryshme në çdo anë të botës duke plotësuar dosjet dhe kriteret e shpallura për këtë qëllim.

Juria vendimarrëse përbëhej nga :

1. Dr. Antonio A. Arantes,
President i Institutit Kombëtar Brazilian për Trashëgiminë Historike dhe Artistike, Brazil.
2. H.R.H Basma Bin Talal,
Princeshë e Jordanisë.
3. Aziza Benanini,
Ambasadore e Marokut në Unesco.
4. Prof. Georges Condominas,
Përfaqësues i Francës në Unesco.
5. Prof. Anzor Ermaichvili,
Profesor në Institutin Kombëtar të Kulturës, Gjeorgji.
6. Carlos Fuentes,
Përfaqësues i Meksikës në Unesco.
7. Mr. Yoshikazu Hasegawa,
Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit për Teatrin e

Ri, Japoni.

8. Prof. Epeli Hau’Ofa,
Drejtor Themelues i Qendrës për Artin dhe Kulturën, Oqeani.
9. Prof. Alpha Oumar Konare,
Kryetar i Komisionit të Bashkimit Afrikan, ish President i Malit.
10. Elvira Kunina,
Drejtoreshë e Shkollës Kombëtare të Artit Folklorik, Rusi.
11. M.s. Olive W.M. Lewin,
Drejtoreshë e të rinjve, Xhamajkë.
12. Prof. Armandina Lihamba,
Prof. në Universitetin e Dar El Salami, Tanzani.
13. Dr. Ahmed Morsi,
Kryetar i Bibliotekës dhe librarive kombëtare, Prof. në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Kajros, Egjipt.
14. Dr. Zhentao ZHANG
Prof. në Institutin e Kërkimeve Muzikore në Akademinë e Arteve, Kinë.

Qysh sot iso-polifonia jonë popullore, kjo dukuri e jashtëzakonshme e të konceptuarit dhe e komunikimit njerëzor ka zënë vendin që meriton: në listën e kryeveprave të botës shpirtërore të njerëzimit. Kjo listë e kryeveprave në thelb përbëhet nga fenomene dhe shfaqje dukurish të kulturave shpirtërore të popujve të ndryshëm të botës që janë në themel të kulturës njerëzore dhe që dallohen për frymën dhe llojin unikal që ato përfaqësojnë. Ndër to përmendim: makamet e Irakut, operan e Pekinit, vedat indiane etj.

Një sistem për të krijuar qeliza staminale pa përdorur ato shtazore

Një grup kërkuesish amerikanë kanë zhvilluar një sistem për të kultivuar qeliza staminale pa përdorur qeliza kafshësh e në vend të tyre përdorin vetëm dy linja të reja qelizore nga embrione njerëzore. Iniciativa ishte e studuesve të WiCell Research Institute, një laborator privat i lidhur me Universitetin Wisconsin-Madison (ShBA).

Studimi i tyre u publikua në *Nature Biotechnology*, dhe përbën një hap të vogël drejt përdorimit klinik të qelizave staminale. Mospërdorimi i qelizave shtazore eviton problemet e mundshëm që lidhen me praninë e viruseve që mund të kalojnë tek njerëzit.

“Kemi optimizuar mënyrën e kultivimit – shpjegon Tenneille Ludwig – e kjo është hera e parë që ne mund të marrim linja të reja qelizore në kushte tërësisht të përcaktuara e pa prodhime shtazore”.

Nature Biotechnology

Grurë omgj kundër thatësirës

Duke shkuar në trashëgiminë gjenetike të grurit, studiuesit meksikanë të International Maize and Wheat Improvement Center (CIMMYT) arritën të krijojnë varietete të reja gruri për mjediset e thata. Gruri i përdorur sot (*Triticum aestivum*) është prodhim i një ngjarjeje gjenetike që ka ndodhur dy herë gjatë Epokës së Gurit, kryqëzimit midis dy specieve të ndryshme duke krijuar kështu një hibrid pjellor që ka dyfishin e kromosomeve në krahasim me speciet fillestare.

Ngjarja e parë ka ndodhur rreth 30 mijë vjet më parë me kryqëzimin e grurit të egër (*Triticum monococcum*) dhe një bimë barishtore (*Aegilops speltoides*). Kjo i dha jetë një gruri primitiv të quajtur Emmer me katër çifte kromozomesh. Ngjarja e dytë ka ndodhur 9 mijë vjet më parë kur gruri Emmer u kryqëzua me një tjetër bimë barishtore (*Aegilops tauschii*) duke i dhënë origjinë

një hibridi me gjashtë çifte kromozomesh. Falë farave të tij më të mëdha ai u bë i preferuari i bujqve të të gjithë kohërave. Por ky sukses kish edhe anën tjetër të medaljes sepse biodiversiteti i tij ishte minimal e si rrjedhojë edhe aftësia e tij për tju përshtatur mjedisit.

Duke përdorur teknikat e inxhenjerisë gjenetike, kërkuesit meksikanë rikrijuan në laborator këto ndodhi të kaluara, në kërkim të kombinimeve të reja të kromosomeve për të përmirësuar më tej grurin. Në një nga këto teste u arritën përmirësime të kënaqshme në drejtim të qendrueshmërisë ndaj thatësirës. Hibridet e marrë treguan një prodhimtari 20-40 për qind më të lartë në krahasim me varietetet tradicionale në situatë thatësire. Sipas ekspertëve të kësaj fushe, mund të jemi në fillim të një revolucioni të plotë gjenetik të grurit.

Nature

U dekodifikua gjenoma e tre kërpudhave patogjene

Një konsorcium ndërkombëtar studiuesish të drejtuar nga Universiteti i Mançesterit deshifroi kodin gjenetik të tre specieve të një familjeje kërpudhash patogjene të njohur: *Aspergillus fumigatus*, *Aspergillus nidulans* e *Aspergillus oryzae*. Rezultatet e analizës janë publikuar në numrin e datës 22 dhjetor të revistës *Nature*. Edhe pse janë pjesë e të njejtës familje kërpudhash, tre sekuencat gjenomike janë gjenetikiisht të ndryshme midis tyre ashtu si ato të peshqve dhe njeriut.

Aspergillus janë kërpudha të zakonshme që transportohen nëpërmjet ajrit në formën e sporeve. Normalisht ato nuk janë të dëmshme por specia *Aspergillus fumigatus* qysh nga viti 1848 është parë si burim infeksioni: bëhet fjalë për shkakun e parë infektiv vdekjeprurës tek pacientët me leuçemi e ata që i nënshtrohen trapiantimit të palcës kurrizore. *Aspergillus nidulans* është përdorur si një sistem eksperimental gjatë pesëdhjetë viteve të fundit duke kontribuar në zbulimin e shumë proceseve qelizore bazë. Së fundi, *Aspergillus oryzae* në Lindjen e Largët përdoret prej dymijë vjetësh për të prodhuar sakë (verë nga orizi), mizo (pastë soje) e shoyu (salsë soje).

Kërkuesit kanë zbuluar se të tre speciet kanë të

përbashkët vetëm 68 përqind të proteinave të tyre, një përqindje kjo e ngjashme me atë që kanë gjitarët dhe peshqit, që u ndanë 450 milionë vjet më parë. Të tre kërpudhat ndryshojnë në shkallë të konsiderueshme për nga përmasat e gjenomës: ajo e *A. oryzae* është 31 përqind më e madhe se ajo e *A. fumigatus* dhe 24 përqind më e madhe se ajo e *A. nidulans*. Është kurioz fakti që mbi 30 përqind e rreth 14500 gjeneve të identifikuar janë plotësisht të rinj për shkencën dhe kanë një funksion apo një strukturë ende të panjohur.

“Të gjitha kërpudhat, përfshi këtu edhe familjen *Aspergillus* – komenton David Denning, koordinator i projektit – kanë një rol kritik në ekosistemin tokësor dhe janë përgjegjës për gati gjithë degradimin e materialit bimor përveç riciklimit të azotit. *Aspergillus fumigatus* është një nga përbërësit kryesorë të kompostit dhe kërpudha të tjera janë burim i rëndësishëm barnash mjekësore, përfshi penicilinën dhe ciklosporinën. Gjithsesi ato prodhojnë edhe toksina, shkaktojnë infeksione e janë burim alergjik. Studimi i hollësishtëm i këtyre vargjeve gjenomike do të na japë mundësinë për të zbuluar se përse ky grup kërpudhash është kaq i rrezikshëm”.



TE ARSYETOJME SHKENCERISHT...

Po fillojmë me një problem të Leonardo Da Vinçit. Në një oborr ndodhen disa pula e lepuj. Gjithsej numërohen 40 kokë dhe 100 këmbë. Sa janë pulat dhe sa lepujt?

Për t'ju ardhur në ndihmë ju themi se Leonardo e shpjegoi me pak fjalë metodën e tij për zgjidhjen e problemit në këtë mënyrë:

"Elchataim quidem arabice, latine duarum falsarum positionum regula interpretatur, per quam fere omnium quaestionum solutio invenitur". E qartë, apo jo?

LOGJIKA E FORTE...

Ky kuiz i atribuohet Ajnshtajnit. Ai e përsëriste se 98% e njerëzve nuk do të arrinin ta zgjidhnin atë. Doni ta provoni edhe ju këtë sfidë? Mjafton pak durim e pak logjikë e ftohtë...

Në një rrugë ndodhen 5 shtëpi me 5 ngjyra të ndryshme. Në secilën shtëpi jeton një person me kombësi të ndryshme. Secili prej tyre pi një pije të ndryshme, përdor cigare të ndryshme dhe ka një kafshë shtëpiake të ndryshme. Ndër të tjera:

- Anglezi jeton në shtëpinë e kuqe.
- Suedezi ka një qen.
- Danezi pi çaj.
- Shtëpia e gjelbër ndodhet në të majtë të shtëpisë së bardhë.
- I zoti i shtëpisë së gjelbër pi kafe.
- Zotnia që pi cigare Pall Mall ka dy kanarina.
- I zoti i shtëpisë së verdhë pi cigare Dunhill.
- Zotnia që banon në shtëpinë e mesit pi qumësht.
- Norvegjezi jeton në shtëpinë e parë.
- Zotnia që pi duhan Blends me llullë jeton në krah të atij që ka një mace.
- I zoti i kalit jeton në krah të atij që pi cigare Dunhill
- Zotnia që pi cigare Bluemasters pi birrë.
- Gjermani pi cigare Prince.
- Norvegjezi jeton pranë shtëpisë blu.
- Zotnia që pi duhan Blends vive jeton pranë atij që pi ujë.

Pyetja është: Kush e ka peshkun e kuq?

? Pyetje & Përgjigje ?

Përse vetëm plumbi thith rrezet X?

Kur një rrezatim X arrin një metal, rrezet transferojnë tërë energjinë e tyre ose një pjesë të saj tek elektronet e metalit të cilët si pasojë shkëputen nga atomet e tyre. Ky është procesi i jonizimit. Ndërveprimi midis një rrezatimi X dhe atomeve të metalit është një funksion probabiliteti që rrezatimi të arrijë tek elektronet e atomeve.

Si rrjedhojë, sa më i lartë të jetë densiteti i metalit aq më e lartë mundësia që rrezatimi X ti japë elektroneve një pjesë të mirë të energjisë së tij.

Plumbi është pikërisht metali më i zakonshëm ndër ata me densitet të lartë. Në realitet, edhe elementë më të dendur se plumbi, si urani p.sh., mund të funksionojnë teorikisht, por të pengojmë rrezet X me uran nuk duket të jetë një ide shumë e goditur!